



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 94
Prishtinë, më 21 janar 2013

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 21, 24, 25 DHE 30 JANAR 2013**

Mbledhjen e kryesoi Xhavit Haliti, nënkryetar i Kuvendit.

Kryesuesi i deklaroi të hapura punimet e Sesionit pranveror dhe procedoi me rendin e ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Në lidhje me plotësimin e rendit të ditës, për fjalë u paraqit deputeti Ismet Beqiri.

Ismet Beqiri, në emër të GP të LDK-së, propozoi që mbledhja e sotme plenare të shtyhet për ditën e enjte, më 24.1.2013. Ai këtë propozim e arsyetoi me faktin se sot është përvjetori i shtatë i vdekjes së presidentit Ibrahim Rugova dhe është paraparë mbajtja e një varg aktiviteteve institucionale.

Kryesuesi në vazhdim kërkoi deklarin e kryetarëve apo përfaqësuesve të grupeve parlamentare lidhur me propozimin e deputetit Ismet Beqiri.

Adem Grabovci, në emër të GP të PDK-së, e përkrahu propozimin e paraqitur nga GP i LDK-së.

Visar Ymeri, në emër të GP të Lëvizjes “Vetëvendosje”, tha se edhe pse sot kemi mjaft për të diskutuar lidhur me zhvillimet e fundit, nëse shumica e deputetëve e përkrahin propozimin për shtyrje, atëherë edhe ne do ta bëjmë një gjë të tillë.

Ardian Gjini, në emër të GP të AAK-së, e përkrahu propozimin për shtyrjen e mbledhjes së sotme plenare.

Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, gjithashtu e përkrahu propozimin e GP të LDK-së për shtyrjen e mbledhjes së sotme plenare.

Sasha Milosavleviq, në emër të Grupit Parlamentar SLS, e përkrahu propozimin për shtyrjen e mbledhjes së sotme plenare.

Albert Kinolli, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, e përkrahu propozimin për shtyrjen e mbledhjes së sotme plenare.

Kryesuesi Xhavit Haliti e hodhi në votim propozimin e deputetit Ismet Beqiri që mbledhja e sotme plenare të shtyhet.

Kuvendi e miratoi propozimin e lartpërmendur.

Kryesuesi konstatoi se për terminin e vazhdimit të mbledhjes plenare do të vendosë Kryesia e Kuvendit.

Kryesuesi i përfundoi punimet e mbledhjes së sotme në orën 9:30 minuta.

* * *

E enjte, më 24 janar 2013

Vazhdimi i mbledhjes plenare

Mbledhjen e kryesoi kryetari Jakup Krasniqi, ndërsa i ndihmoi nënkryetari Xhavit Haliti.

Kryetari Jakup Krasniqi e deklaroi të hapur vazhdimin e punimeve të mbledhjes plenare, të filluar më 21 janar 2013.

Ai tha se në radhë është vazhdimi i punimeve të mbledhjes plenare me pikat, si në vijim:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën deputetët: Vjosa Osmani, Halit Krasniqi, Liburn Aliu, Donika Kadaj-Bujupi, Myzejene Selmani, Ismet Beqiri, Sasha Milosavleviq, Zenun Pajaziti dhe ministri Enver Hoxhaj, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputetja Time Kadrijaj parashtroi pyetje për ministrin Ferid Agani në lidhje me krijimin e Komisionit për verifikimin e shkeljeve ligjore eventuale në QKUK. Ministri Ferid Agani iu përgjigj pyetjes së deputetes Time Kadrijaj.

Deputeti Halit Krasniqi parashtroi pyetje për zv/kryeministrin Hajredin Kuçi në lidhje me krijimin e mundësive ligjore në përshejtimin e procedurave për angazhimin e avokatëve mbrojtës me shtetësi të huaj për mbrojtjen e të akuzuarve me motive nga lufta e UÇK-së. Zv/kryeministri Hajredin Kuçi nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Halit Krasniqi parashtroi pyetje për ministrin Agim Çeku në lidhje me masat që mund t'i ndërmarrë Ministria e FSK-së për trajtimin e stafit civil të ish-TMK-së, të cilët me rastin e transformimit në FSK kanë mbetur të papunë dhe të pasistemuar.

Ministri Agim Çeku iu përgjigj pyetjes së deputetit Halit Krasniqi.
Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për transplantimin e organeve,
5. Shqyrtimi i Propozimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Universitetit të Prishtinës,
6. Shqyrtimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit kundër korrupsionit për periudhën 2013-2017,
7. Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media,
8. Zgjedhja e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.

3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme

Kuvendi e miratoi pa asnjë vërejtje procesverbalin e mbledhjes plenare, të mbajtur më 20 dhjetor 2012.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për transplantimin e organeve

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për transplantimin e organeve.

Ministri Ferid Agani tha se ky projektligj ka për qëllim rregullimin e marrjes së organeve apo pjesëve të organeve nga personi i gjallë apo i vdekur për transplantim te personi tjetër me qëllim mjekimin.

Në vazhdim tha se shërbimet themelore të përfshira në veprimtarinë e transplantimit të organeve kanë të bëjnë me: organizimin, funksionimin, inspektimin, bashkërendimin, licencimin dhe akreditimin e strukturave shëndetësore, të përfshira në veprimtarinë e transplantimit të organeve.

Më tej, ai vuri në pah se projektligji ka për qëllim që të parandalojë dhe sanksionojë keqpërdorimin e organeve njerëzore, veçanërisht në aktivitetet komerciale në kontekst të transplantimit të organeve dhe ta mbrojë dinjitetin, privatësinë dhe shëndetin human të dhuruesit-marrësit.

Ai më pas u fokusua në strukturën dhe përmbajtjen e projektligjit dhe i ftoi deputetët për miratimin e tij në parim.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për transplantimin e organeve.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Fikrim Damka, në emër të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale; Salihe Mustafa, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Nazane Breca, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Liburn Aliu, në emër të

Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” ; Time Kadrijaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Gëzim Kelmendi, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, ndërsa Myfera Shinik, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për transplantimin e organeve. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 59,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për transplantimin e organeve.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, si Komision Funkcional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

5. Shqyrtimi i Propozimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Universitetit të Prishtinës

Deputeti Idriz Vehapi, në emër të Komisionit Funkcional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, tha se si komision e kemi shqyrtuar propozimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Universitetit të Prishtinës dhe kemi rekomanduar miratimin e tij në mbledhje plenare.

Kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin e propozimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Universitetit të Prishtinës.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutoi edhe deputetja Xhevahire Izmaqi, në emër të GP të PDK-së, diskutimi i së cilës është dhënë i plotë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim propozimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Universitetit të Prishtinës.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 43,
Kundër ----- 1,
Abstenime ----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë:

V E N D I M

Miratohet ndryshimi dhe plotësimi i Statutit të Universitetit të Prishtinës për emërimin e tij në Universitet Publik “Hasan Prishtina”, në Prishtinë.

6. Shqyrtimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit kundër korrupsionit për periudhën 2013-2017

Deputeti Behar Selimi, në emër të Komisionit Funkcional për Legjislacion, tha se si komision e kemi shqyrtuar propozim-Strategjinë dhe Planit të Veprimit kundër korrupsionit për periudhën 2013-2017 dhe kemi rekomanduar miratimin e tij në mbledhje plenare.

Kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin e Propozim-strategjisë dhe Planit të Veprimit kundër korrupsionit për periudhën 2013-2017.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Behar Selimi, në Grupit Parlamentar të PDK-së; Arben Gashi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Albulena Haxhiu, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Burim Ramadani, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Gëzim Kelmendi, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re; Duda Balje, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe Hykmete Bajrami, Albin Kurti, Zenun Pajaziti, Sabri Hamiti, Visar Ymeri, Rita Hajzeraj-Beqaj, Eqrem Kryeziu, Hydajet Hyseni, Haki Demolli, Arben Gashi, Lutfi Haziri, Jakup Krasniqi, Vjosa Osmani, Armend Zemaj, Behar Selimi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas diskutimeve për këtë pikë të rendit të ditës, kryetari konstatoi se Kuvendi e mori këtë:

PËRFUNDIM

Ngarkohen Komisioni për Legjislacion dhe Komisioni për Integritet Evropiane që, mbi bazën e diskutimeve në mbledhje plenare, ta plotësojnë tekstin e propozim-Strategjisë dhe Planin e Veprimit kundër korrupsionit për periudhën 2013-2017.

Teksti i plotësuar t’i procedohet Kuvendit për miratim në njërin nga mbledhjet e radhës.

7. Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media

Kryetari i informoi deputetët se Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media i ka shqyrtuar nominimet e kandidatëve për anëtarë të Komisionit të Pavarur për Media dhe Kuvendit ia ka paraqitur rekomandimin për miratim.

Arsyetimin e raportit me rekomandime në emër të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media e paraqiti deputeti Behar Selimi.

Më tej, kryetari sqaroi se për zbatimin e procedurës së votimit të fshehtë kërkohet krijimi i një komisioni votues nga përbërja e deputetëve, me mbështetje të zyrtarëve të Administratës, dhe i ftoi përfaqësuesit e grupeve parlamentare që të propozojnë nga një anëtar për Komisionin votues.

Grupet parlamentare i propozuan këta anëtarë:

1. G/P PDK - Nijazi Idrizi,
2. G/P LDK - Salih Morina,
3. G/P “Vetëvendosje” - Albana Gashi,
4. G/P AAK - Kymete Bajraktari,
5. G/P - Koalicioni Kosova e Re - Jeton Svirca,
6. G/P - SLS - Milivoje Stojanoviq,
7. G/P- “6+” - Fikrim Damka.

Kuvendi e miratoi emërimin e anëtarëve në Komisionin votues.

Më pas, kryetari i propozoi Kuvendit që pika nr. 7 dhe pika nr. 8 e rendit të ditës **Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media dhe Zgjedhja e anëtarëve të Bordit të Radio Televizionit të Kosovës** të votohen përnjëherë.

Ai më tutje tha se edhe Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës i ka shqyrtuar nominimet e kandidatëve për anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës dhe Kuvendit i ka paraqitur rekomandimin për miratim.

Në lidhje me votimin e përnjëhershëm të pikave nr. 7 dhe 8 të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët Ismet Beqiri dhe Arsim Bajrami, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Më pas, arsyetimin e raportit me rekomandime në emër të Komisionit ad hoc për zgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës e paraqiti deputetja Teuta Haxhiu.

Në vazhdim, deputetët u ftuan një nga një për të votuar.

Pas numërimit të fletëvotimeve, në emër të Komisionit votues, raportin e paraqiti Nijazi Idrizi.

Ai konstatoi se në votim morën pjesë 85 deputetë, ndërsa të pavlefshme janë 6 fletëvotime. Rezultati i votimit është si në vijim:

- Për një (1) anëtar të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media nga radhët e komunitetit shumicë shqiptar, Luljeta Vuniqi ka fituar 35 vota, ndërsa Safete Rugova ka fituar 37 vota.
- Për një (1) anëtar të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media nga radhët e komunitetit serb, Miroslav Saviq ka fituar 9 vota, ndërsa Vesna Jovanović ka fituar 54 vota.

Ai konstatoi se në bazë të rezultatit të votimit për zgjedhjen e anëtarit të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media nga radhët e komunitetit shumicë shqiptar, procedura e votimit duhet të përsëritet.

Ndërsa anëtare e Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media, nga radhët e komunitetit serb u zgjodh Vesna Jovanović.

Pas numërimit të fletëvotimeve për zgjedhjen e anëtarëve të Bordit të RTK-së, në emër të Komisionit votues, raportin e paraqiti Salih Morina.

Ai konstatoi se prej gjashtë (6) kandidatëve të propozuar nga Komisioni ad hoc, nga radhët e komunitetit shumicë shqiptar, Besa Bytyqi ka fituar 59 vota, Blerta Zeqiri 38 vota, Faton Mehmetaj 44 vota, Ibrahim Kadriu 17 vota, Murat Musliu 23 vota dhe Mustafë Halili 29 vota.

Ndërsa për pozitën e anëtarit nga radhët e komuniteteve tjera joshumicë, Elif Tokmak ka fituar 35 vota, ndërsa Mehdiulki Cibo ka fituar 38 vota.

Ai konstatoi se në bazë të rezultatit të votimit për zgjedhjen e anëtarëve të Bordit të RTK-së nga radhët e komunitetit shumicë shqiptar u zgjodhën Besa Bytyqi dhe Faton Mehmetaj.

Ndërsa procedura e votimit për zgjedhjen edhe të një anëtari të Bordit të RTK-së nga radhët e komunitetit shumicë shqiptar dhe për zgjedhjen e anëtarit nga radhët e komuniteteve tjera joshumicë duhet të përsëritet.

Kandidatët nga radhët e komunitetit shumicë shqiptar, për të cilët duhet të përsëritet procedura e votimit, në bazë të rezultatit të votave të fituara janë: Blerta Zeqiri dhe Mustafë Halili, ndërsa procedura e shpalljes së konkursit publik për përzgjedhjen e kandidatëve nga radhët e komuniteteve tjera joshumicë duhet të përsëritet.

Në vazhdim, kryetari konstatoi se në sallë janë të pranishëm 49 deputetë dhe Kuvendi nuk ka kuorum për t'i zhvilluar punimet e mëtutjeshme. Ai i njoftoi deputetët se vazhdimi i mbledhjes plenare do të bëhet më 25 janar 2013.

Kryetari i konstatoi të mbyllura punimet e mbledhjes së sotme në orën 17:20 minuta.

* * *

E premte, më 25 janar 2013

Vazhdimi i mbledhjes plenare

Mbledhjen e kryesoi kryetari Jakup Krasniqi, ndërsa i ndihmoi nënkryetari Xhavit Haliti.

Kryetari e deklaroi të hapur vazhdimin e punimeve të mbledhjes plenare, të filluar më 21 dhe të vazhduar 24 janar 2013.

Kryetari tha se gjatë votimit të djeshëm nuk kanë përfunduar në tërësi votimet për pikat: *Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media dhe Zgjedhja e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.*

Për procedimin e mëtutjeshëm të pikave të lartpërmendura, kryetari kërkoi deklarimin e përfaqësuesve të grupeve parlamentare.

Adem Grabovci, në emër të GP të PDK-së, tha se grupi që ai përfaqëson është i mendimit që votimi për pikat e mbetura të përsëritet në tërësi. Ai gjithashtu kërkoi që mbledhja e sotme plenare të shtyhet për javën e ardhshme, derisa të sqarohen të gjitha çështjet që kanë ndodhur gjatë votimit të djeshëm.

Ardian Gjini, në emër të GP të AAK-së, tha se çështja e shtyrjes së mbledhjes së sotme plenare mund të diskutohet në Kuvend, ndërsa në lidhje me procedurën e votimit nga mbledhja plenare e djeshme, konstatoi se ka qenë e rregullt, në ndërkohë që pjesa tjetër e votimit për kandidatët që nuk kanë fituar numër të mjaftueshëm të votave, duhet të përsëritet.

Sabri Hamiti, në emër të GP të LDK-së, në lidhje me procedurën e votimit, tha se ajo duhet të vazhdojë sot, ngase mbledhja e djeshme është shtyrë për shkak të mungesës së kuorumit për të votuar. Kuvendi është në procesin e votimeve dhe çdo shtyrje vetëm se do të krijojë konfuzion të mëtutjeshëm, tha ai.

Visar Ymeri, në emër të Lëvizjes “Vetëvendosje”, konstatoi se Kuvendi është në procedurë të votimit dhe se në mbledhjen e djeshme plenare nuk ka pasur asnjë parregullsi lidhur me këtë çështje.

Myzejene Selmani, në emër të GP të Koalicionit Kosova e Re, e përkrahu qëndrimin se Kuvendi është në procedurë të votimit lidhur me pikat e lartpërmendura të rendit të ditës.

Petar Miletiq, në emër të GP SLS, e përkrahu propozimin e përfaqësuesit të GP të PDK-së.

Diskutimet e plota të përfaqësuesve të grupeve parlamentare të lartpërmendura janë dhënë të plota në transkript.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Sabri Hamiti, Adem Grabovci, Arsim Bajrami, Arben Gashi, Muhamet Mustafa, Visar Ymeri, Sali Asllanaj dhe kryesuesi Xhavit Haliti, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas diskutimeve për këtë pikë të rendit të ditës, kryesuesi e hodhi në votim propozimin e kryetarit të GP të PDK-së për shtyrjen e mbledhjes së sotme plenare për javën e ardhshme.

Pas procedurës së votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi nuk e miratoi propozimin për shtyrjen e mbledhjes së sotme plenare për javën e ardhshme.

Më pas, deputeti Adem Grabovci kërkoi një pauzë prej një ore.

Kryesuesi e miratoi kërkesën e deputetit Adem Grabovci.

Diskutimet e plota të deputetit Adem Grabovci dhe të kryesuesit Xhavit Haliti janë dhënë të plota në transkript.

* * *

Pas pauzës, mbledhjen plenare e drejtoi kryetari Jakup Krasniqi, ndërsa i ndihmoi nënkryetari Xhavit Haliti.

Kryetari konstatoi se në sallë janë të pranishëm 44 deputetë.

Në lidhje me procedurën e votimit në mbledhjen e djeshme plenare, kryetari sqaroi se ajo ka qenë e rregullt dhe se nuk ka pasur asnjë vërejtje lidhur me këtë çështje.

Për këtë çështje diskutoi edhe deputeti Sabri Hamiti.

Diskutimet e plota të kryetarit Jakup Krasniqi dhe të nënkryetarit Sabri Hamiti janë dhënë të plota në transkript.

Në mungesë të kuorumit, kryetari i përfundoi punimet e mbledhjes së sotme plenare dhe konstatoi se për vazhdimin e saj deputetët do të njoftohen me kohë.

Kryetari i konstatoi të mbyllura punimet e mbledhjes së sotme në orën 12:35 minuta.

* * *

E mërkurë, më 30 janar 2013
Vazhdimi i mbledhjes plenare

Mbledhjen e kryesoi kryetari Jakup Krasniqi, ndërsa i ndihmoi nënkryetari Xhavit Haliti.

Kryetari e deklaroi të hapur vazhdimin e punimeve të mbledhjes plenare, të filluar më 21 janar dhe të vazhduar më 24 dhe 25 janar 2013.

Ai konstatoi se në sallë janë të pranishëm 75 deputetë dhe procedoi me pikat e rendit të ditës, si në vijim:

- 1. Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media,*
- 2. Zgjedhja e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.*

1. Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media

Kryetari i njoftoi deputetët se sipas rezultateve të votimit, në seancën plenare të mbajtur më 24 janar 2013, për anëtarë të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media, nga radhët e komunitetit shumicë shqiptar kanë qenë të propozuara dy kandidatë, por asnjëra nuk i ka fituar votat e nevojshme.

Kurse për anëtar të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media nga radhët e komunitetit serb është zgjedhur znj. Vesna Jovanović, e cila i ka fituar votat e mjaftueshme.

Ai konstatoi se Kuvendi e nxori këtë:

V E N D I M

Për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media

- 1. Vesna Jovanović** zgjidhet anëtare e Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media, me mandat tre (3) vjeçar.
2. Komisioni i Pavarur për Media duhet të nxjerrë shpallje publike për zgjedhjen e një (1) anëtarë nga radhët e komunitetit shumicë shqiptar, në pajtim me nenin 11.2 të Ligjit për KPM.

Më pas, kryetari dha sqarime edhe për pikën nr. 2 të rendit të ditës, si në vijim:

2. Zgjedhja e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës

Kryetari i njoftoi deputetët se sipas rezultateve të votimit, në mbledhjen plenare të mbajtur më 24 janar 2013, për anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, në votimin e parë, nga gjashtë kandidatët e propozuar, nga radha e komunitetit shumicë shqiptar është dashur të zgjidhen tre kandidatë, kurse vetëm dy kandidatë i kanë fituar votat e mjaftueshme, Besa Bytyqi dhe Faton Mehmetaj.

Kandidatët me numrin më të vogël të votave, Ibrahim Kadriu dhe Murat Musliu, hiqen nga lista.

Në vazhdim, kryetari tha se në rundin e dytë të votimit edhe për një anëtar duhet të shkojnë dy kandidatë të tjerë, që kanë fituar më shumë vota: Blerta Zeqiri dhe Mustafë Halili.

Më tej, kryetari sqaroi se në mbledhjen e sotme duhet të votohet një kandidat, nga dy të propozuar për anëtar të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.

Në vazhdim, ai i ftoi anëtarët e Komisionit të votimit, që janë emëruar në mbledhjen plenare të mbajtur më 24 janar 2013, që t'i zënë vendet e tyre dhe të fillojnë me procedurat e votimit të fshehtë.

Nga GP i Koalicionit Kosova e Re, në Komisionin votues u propozua deputetja Sevdije Lama. Kuvendi e miratoi përbërjen e Komisionit votues.

Pas numërimit të fletëvotimeve për zgjedhjen e anëtarëve të Bordit të RTK-së, në emër të Komisionit votues, raportin e paraqiti deputeti Nijazi Idrizi.

Nijazi Idrizi tha se në votim kanë marrë pjesë 106 deputetë, ndërsa 39 fletëvotime janë të pavlefshme.

Ai konstatoi se nga kandidatët e propozuar nga Komisioni ad hoc nga radhët e komunitetit shumicë shqiptar, Blerta Zeqiri ka fituar 20 vota, ndërsa Mustafë Halili ka fituar 47 vota.

Më pas, kryetari konstatoi se Kuvendi e mori këtë:

V E N D I M

Për zgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës

1. Anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, me mandat tre (3) vjeçar zgjidhen:

1. Besa Bytyqi dhe

2. Faton Mehmetaj.

2. Radiotelevizioni i Kosovës duhet të bëjë shpallje publike për zgjedhjen e një (1) anëtari të Bordit të RTK-së nga radha e komunitetit shumicë shqiptar dhe për një anëtar të Bordit të RTK-së nga radha e komuniteteve joshumicë, në pajtim me nenin 26.2 të Ligjit për Radiotelevizionin e Kosovës.

* * *

Kryetari i konstatoi të mbyllura punimet e mbledhjes së sotme, në orën 12:05 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

*Procesverbalin e hartoi:
Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale*